

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Gazmend Bahtiri dhe sekretaren juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M. nga V., rr. "...” nr.26, me vendbanim në Sh. të Gj., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.41/14, të datës 07.05.2015, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor publik më dt. 22.07.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit Hava Krasniqi, të akuzuarit B. M. dhe përfaqësuesit të dëmtuarës DBPZHR – F. R., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 25.07.2016 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

**B. M.**, nga i ati Xh. dhe nëna F., e vajzërisë S., i lindur më *data e lindjes...*, nga V., rr. "...” nr.26, me vendbanim në Shtutgart të Gjermanisë, me numër personal të identifikimit të Kosovës: *numri personal...*, dhe numër personal të identifikimit të Gjermanisë: *numri personal...*, ka të kryer Shkollën e Mesme të Bujqësisë në Gj., shofer i autobusit në Sh., i martuar, baba i 1 (një) fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Konform nenit 363 par.1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së,**

## REFUZOHET AKTAKUZA

### S e p s e:

Më datën 10.11.2013, rreth orës 14:30, në pyllin publik të quajtur "K.", në regjionin ekonomiko-pyjor të P., KK P., me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në P., i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja i pyllit me traktor dhe sharrë motorike duke prerë 46 copë trungje të llojit ahu, me dimensione 10-12 metra, diametër 16-20cm, me vëllim të përgjithshëm 4.53m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në P. i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 693 €, -

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën, PP.II.nr.41/14, të datës 07.05.2015, kundër të akuzuarit B. M. nga V., rr. "...” nr.26, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor publik me datë 22.07.2016, në të cilin prezantuan Prokurori i Shtetit Hava Krasniqi, i akuzuari B. M. dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës DBPZHR – F. R.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se tërhiqem nga ndjekja penale ndaj të pandehurit B. Xh. M. për arsye se dëshmitarët – rojet e pyllit S. Rr. dhe E. R. nuk kanë arritur ta identifikojnë të pandehurin, andaj konform nenit 52 të KPPRK-së, tërhiqem nga ndjekja penale për të pandehurin B. Xh. M.

Meqenëse Prokurori i Shtetit hoqi dorë nga ndjekja penale, Gjykata mori aktgjykim refuzues me të cilin refuzohet aktakuza për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil mbështetet në nenin 463 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par.1 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.446/2015, me datë 25.07.2016**

**Sekretarja juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.